

Editorial nga Pieter Feith, Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian në Kosovë, për gazetën "Zëri"

Një e ardhme më e mirë për të gjithë në Kosovë

Bashkimi Evropian tashmë ka vendosur ta përkrahë popullin e Kosovës me më tepër resurse për person se për çdo vend tjetër në botë. Sot Komisioni do të deklarojë kontributin e tij shtesë për të njëjtën periudhë kohore. Nga njerëzit që kam takuar në Kosovë kam kuptuar se kosovarët kanë vullnetin dhe iniciativën që t'i përdorin si duhet ofertat e donatorëve

Sot po mbahet në Bruksel Konferenca e shumëpritur dhe e shumënevojitur e Donatorëve për Kosovën. Unë në veçanti falënderoj Komisionin Evropian për organizimin dhe mikpritjen e kësaj ngjarjeje të rëndësishme. Përfaqësuesit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të donatorëve kryesorë, dhe të organizatave ndërkombëtare janë mbledhur këtu sot për të përkrahur zhvillimin e Kosovës. Për mua mbajtja e kësaj konference në Bruksel - në kryeqendrën e BE-së - është e një vlere të rëndësishme simbolike. Ajo thekson se angazhimi ynë i fuqishëm politik për të ardhmen evropiane të Kosovës kombinohet gjithashtu edhe me ndihmën financiare në rritje.

Bashkimi Evropian tashmë ka vendosur ta përkrahë popullin e Kosovës me më tepër resurse për person se për çdo vend tjetër në botë. Sot Komisioni do të deklarojë kontributin e tij shtesë për të njëjtën periudhë kohore. Ky financim i ri i konsiderueshëm do të krijojë kushte më të mira për të gjithë në Kosovë. Nga njerëzit që kam takuar në Kosovë kam kuptuar se kosovarët kanë vullnetin dhe iniciativën që t'i përdorin si duhet ofertat e donatorëve.

Autoritetet e Kosovës janë përgatitur me kujdes për këtë mundësi. Ata kanë hartuar programin e tyre me qëllim të investimit në infrastrukturë për ta lidhur Kosovën me pjesën tjetër të rajonit; të zhvillimit të institucioneve të Kosovës për të konsoliduar demokracinë; të zhvillimit të një sistemi të pavarur dhe të drejtë të sundimit të ligjit; dhe të përmirësimit të kushteve për arsimim për gjithë qytetarët në shoqëri.

Kjo konferencë është e rëndësishme për dy arsye. Së pari, përkrahja financiare e dhënë sot do të thotë se zhvillimi socio-ekonomik mund të përshpejtohet për të krijuar një Kosovë ku të



Pieter Feith

gjithë banorët mund të shpresojnë për të ardhme më të mirë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sundimit të ligjit, decentralizimit dhe reformës në sektorin e sigurisë në përfitim të të gjithëve në Kosovë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fenë dhe gjininë. Së dyti, unë e shoh konfencën e donatorëve në Bruksel si një tjetër provë se Bashkimi Evropian mbetet i gatshëm dhe i bashkuar në angazhimin e tij të madh dhe afatgjatë për Kosovën.

Si rrjedhim, konferenca e sotme është edhe një ngjarje më shumë në vargun e ngjarjeve pozitive të kohëve të fundit për perspektivën evropiane të Kosovës: më 20 qershor të gjithë udhëheqësit e shteteve dhe qeverive të 27 vendeve të Bashkimit Evropian ritheksuan angazhimin e tyre të vazhdueshëm për të siguruar stabilitetin në Kosovë dhe për të ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe politik. Ata e mirëpritën zotimin e Kosovës për parimet e demokracisë dhe barazisë. Ky është një risigurim i fuqishëm nga 27 vendet anëtare të BE-së se ne po shkojmë në drejtimin e duhur.

Si një shenjë konkrete e kësaj misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX, që vepron nën kornizën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe nën aranzhime me OKB-në qëndron i gatshëm për të përkrahur autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit. Ky mision teknik i përqendruar në drejtësi, polici dhe dogana do ta ndihmojë shoqërinë e Kosovës që të krijojë kushte për të tërhequr investimet aq të nevojshme për zhvillimin socio-ekonomik të saj.

Me ekipin tim, unë mbetem i gatshëm që të ofroj këshillat e mia për sa i përket implementimit të atyre që u morën si zotim sot. Ne do të punojmë së bashku me autoritetet e Kosovës për të promovuar zhvillimin e Kosovës së bashku me partnerët rajonalë në linjë me perspektivën më të gjerë të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Por, më lejoni ta përsëris: Në vitet në vazhdim, përgjegjësia përfundimtare për zhvillimet në këtë drejtim mbetet tek populli i Kosovës. Zgjedhjet tuaja do të përcaktojnë të ardhmen tuaj.

omologun belg Karel de Gucht /palëshe të Kosovë

të të dy vendeve, z. Hyseni dhe z. De Gucht nënshkruan tre marrëveshje që kanë të bëjnë me përkrahjen financiare të qeverisë belge për Institucionet e Kosovës, zëgjësisht për Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP); Projektin për Kontrollin e armëve të vogla (UNDP) dhe Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë (OIK). Sipas marrëveshjeve në fjalë, përkrahja financiare për Agjencinë Kosovare të Pronës do të jetë në shumën prej 100.000 euro, ajo për Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, po ashtu në shumën prej 100.000 euro, ndërsa përkrahja për Projektin e kontrollit të armëve të vogla, është në shumën prej 30.000 euro.